

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

Një video bëri xhiron e rrjetit këtë javë: një grup vajzash adoleshente rriheshin me njëra-tjetrën, shanin dhe mallkonin si të rritura të dala jashtë binarit. Pak ditë më vonë, në qendër të qytetit, një grup djemsh u rrahën me njëri-tjetrin, duke treguar egërsi dhe urrejtje, pa e vrarë mendjen se aty mund të kalonte një i moshuar apo një nënë me fëmijë. Egërsi dhe urrejtje është ajo që po jetojmë këtë javë, si një platformë e ushqyer pak nga pak çdo ditë, çdo vit, ndaj asnjëri prej nesh këtu nuk mund të heshtë dhe nuk mund të shikojë drejt këtij parlamenti, kësaj salle, pa pyetur veten nëse ka ndonjë përgjegjësi. Egërsi dhe urrejtje është ushqyer prej më se një viti në betejat pa fund për të marrë foltoren, për të marrë godinën, për të marrë vulën dhe nuk e di çfarë tjetër, por egërsia dhe urrejtja janë një binom për të cilin ne kemi përgjegjësi, për të cilin ata që kanë hequr dorë të na shohin, nuk ndihem krenarë. I gjithë ky sesion parlamentar është zhvilluar në këtë simfoni të padurueshme zhurme pa arsye, duke shpikur çdo manovër për të vrarë parlamentarizmin dhe për ta bërë të zyrtë të sotmen, por, mbi të gjitha, për ta bërë më zi të ardhmen, sepse kështu, sterrë, e shikoni të gjithë ju që jeni jashtë dhe larg pushtetit. Këtë herë sebepi i debatit ishte çështja “McGonigal”, të cilën Tirana opozitare, me lehtësinë e padurueshme të mungesës së logjikës dhe padurimin për të pritur, e konsideroi menjëherë si skandal qeveritar. Sëmundja e kahershme e të përfolurit, e të folurit me kompetencë të plotë juridike për çështje e fakte që janë në duart e organeve të drejtësisë, është shtruar këmbëkryq edhe në këtë parlament. Nevoja e opozitës për një fasadë betejash, për një betejë të fituar në serialin e saj të pafund të humbjeve, si dhe pritshmëria për humbjen e garantuar në takimin e ardhshëm të majit me qytetarët shqiptarë, e ka çuar në drejtim të paditur parlamentarizmin opozitar, duke lexuar shtrembër çdo dokument dhe çdo akuzë edhe kur nuk ka akuzë. Për sa i përket çështjes për të cilën zhvillohet mocioni i sotëm, kemi javë të tëra që dëgjojmë akuza dhe debate, të cilat paraprijnë gjykatën amerikane, duke analizuar çdo fjali e duke e lakuar atë sipas interesave partiakë, larg të vërtetës. Është i patjetërsueshëm fakti se në aktakuzën e drejtësisë amerikane nuk është ngritur akuzë për asnjë shtetas shqiptar, aq më pak për Kryeministrin Rama. Në përfundim të hetimeve drejtësisë amerikane ka ngritur akuzë vetëm për një ish-zyrtar të lartë, drejtues të FBI-së, për deklarime të rreme dhe falsifikime dokumentesh të lidhura me udhëtimet dhe takimet e tij në Europë dhe Ballkan. Kryeministri Rama ka folur edhe më parë se ditën e sotme në bashkëbisedim me qytetarët dhe asnjëherë nuk i ka fshehur takimet me McGonigal-in, madje i ka pranuar duke theksuar se ato kanë pasur në fokus shkëmbimin e ideve në Ballkan, influencën ruse, ashtu siç ka takuar edhe shumë zyrtarë të vendeve të tjera. McGonigal-i akuzohet se nuk i ka deklaruar udhëtimet e tij, takimet me dokumente zyrtare, sikundër nuk ka deklaruar edhe takimet në vende të tjera, përveçse në Shqipëri. Kjo është shkelja për të cilën akuzohet McGonigal-i.

Të nderuar kolegë deputetë, Jemi betuar të qajmë hallet e njerëzve të thjeshtë, të atyre që na kanë votuar dhe sjellë në këtë sallë, duke bërë ligje dhe debate konstruktive për të përmirësuar jetën e tyre, por jo për ta përkeqësuar atë, kurse ju vini këtu dhe sillni në jetën e shqiptarëve hallet dhe betejat tuaja. Për sa kohë ziheni për të marrë vulën apo foltoren, lëshoheni jo vetëm kundër njëri-tjetrit me sforcë dhe gaz lotsjellës, por mbani peng jetën parlamentare dhe krijoni imazhin që brezi i ri, ato vajza të reja, nuk duhet të shohin dhe, mbi të gjitha, nuk duhet ta shohin si zgjidhje për çdo konflikt që mund t’u dalë në jetë sot e mot. E gjithë kjo histori publike nuk bëhet vetëm për të baltosur pa asnjë fakt qeverinë dhe Kryeministrin, po mbi të gjitha, bëhet për të baltosur imazhin e Shqipërisë, të cilin të gjithë ne që kemi jetuar në vitin e mbrapshtë 1997 e dimë se me sa mund dhe vështirësi u përpoqëm,

të gjithë ne shqiptarët, të largojmë atë imazh nga të gjithë njerëzit, të cilët kur vinin në Shqipëri çliroheshin nga imazhi i dhunës të vitit 1997, ndërkohë që ju keni ende guxim të bëni thirrje për të njëjtat skema. Interesat personalë të opozitës nuk mund të lidhen me imazhin e Shqipërisë. Shqipëria u takon shqiptarëve, atyre që janë punëtorë, paqësorë, që e duan këtë vend të qetë dhe njëkohësisht duan të mundësojnë qetësi për fëmijët e tyre. Ta lëmë gjykatën amerikane të shprehet për shtetasit e saj, të lëmë organet tona të drejtësisë të shprehen për shtetasit shqiptarë, të cilët mund të përballen me drejtësinë për çështje të ndryshme, dhe të mos flasim para kohe. Boll i ushqyem shqiptarët me telenovela, sepse mjafton një eksperiment social si “Big Brother” për të parë më tej, ose për të mos na parë fare dhe këtu jam shumë dakord me zotin Braçe. Unë nuk e di sa veta janë duke na ndjekur ne? Ose do të shikojmë vetëm njëri-tjetrin në ditët dhe javët në vijim. Koha dhe shqiptarët janë gjyqtarët tanë të përbashkët. Të dyja, edhe koha, edhe shqiptarët, japin ndëshkimin dhe ndëshkimi për ju është të jeni ende në opozitë. Ju mund të vazhdoni të silleni në Kuvend si adoleshentë të zemëruar në rrugë. Kjo është zgjedhja juaj, por jo zgjidhja për atë që është Shqipëria. Faleminderit!